



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr./Br. 36/23
Datë/Datum. 25.01.2023
PRISHTINË - PRIŠTINA

RAPORTI IEKSPERTIT SHQYRTUES

Idriz Cufaj	16/01/2023	25/01/2023	Nr. 36/23
Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	Data e autorizimit të ekspertit	Data e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës:

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 12.01.2023, OE NNP "NDREQIMI", ka parashtruar ankesë me nr: 36/23, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "ITEM EL" SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Mirëmbajtja e Ndriqimit Publik" me nr. të prokurimit: OB614-22-13548-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL - OBILIQ.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbime, vlera e parashikuar e kontratës: 40,000.00€.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

(Të përshkruhen dispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).

Neni 1 i LPP-së

Neni 7 i LPP-së

Neni 56 i LPP-së

Neni 59 i LPP-së

Neni 61 i LPP-së

Neni 69 i LPP-së

Neni 41 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "NDREQIMI" lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja e Ndriqimit Publik", me numër të prokurimit: OB614-22-13548-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal - Obiliq.

Ne me dt.28.12.2022 kemi pranuar njoftimin mbi vendimin, ku është rekomanduar për kontratë OE " Item EL " SH.P.K, ndërsa ne jemi shpallur si tenderues i pasuksesshëm. Ne kemi pasur qasje në dokumente të OE të rekomanduar për kontratë, e ku kemi vërejtë se ky OE është i papërgjegjshëm për shumë arsye, e të cilat janë të cekura më poshtë:

Fillimisht OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me çmime jo normalisht të ulëta. I njëjti operator ekonomik prej 97 pozicioneve gjithsejtë sa janë, në 54 prej tyre ka ofertuar me çmime jo normalisht të ulëta. Në pozicionin Nr.5 (trupat Led) ka ofruar çmim prej 30 euro, kurse në treg çmimi i këtij pozicioni sillet rreth 40 euro. Në pozicionin Nr.11 (CN 160 A si 380 V) ka ofruar çmim prej 0.2 euro, kurse në treg çmimi i këtij pozicioni sillet rreth 20 euro. Ky çmim i ofruar është jashtëzakonisht i lirë, madje as nuk mund të quhet çmim kur krahasohet me çmimet e tregut.

Në pozicionin Nr.25 dhe 26 (pllaka për trupa ndriqes) ka ofruar çmim prej 0.1 euro, kurse në treg çmimi i këtyre pozicioneve sillet rreth 4 euro. Në pozicionin Nr.29 ka ofruar çmim prej 0.1 euro, kurse në treg çmimi i këtyre pozicioneve sillet rreth 8 euro. Në pozicionin Nr.54 ka ofruar çmim prej 0.1 euro, kurse në treg çmimi i këtyre pozicioneve sillet rreth 4 euro. Në pozicionin Nr.57 ka ofruar çmim prej 0.1 euro, kurse në treg çmimi i këtyre pozicioneve sillet rreth 4 euro. Në pozicionin Nr.58 ka ofruar çmim prej 0.1 euro, kurse në treg çmimi i këtyre pozicioneve sillet rreth 2 euro. Në pozicionin Nr.93 ka ofruar çmim prej 0.1 euro, kurse në treg çmimi i këtyre pozicioneve sillet rreth 8 euro. Në pozicionin Nr.94 ka ofruar çmim prej 0.1 euro, kurse në treg çmimi i këtyre pozicioneve sillet rreth 1.5 euro. Në pozicionin Nr.96 ka ofruar çmim prej 0.1 euro, kurse në treg çmimi i këtyre pozicioneve sillet rreth 5 euro.

Në Pozicionet 9 dhe 10 çmime janë ofruar çmime prej 0.2 euro, Në pozicionet: 15,16,27,28,29,30,31,32,34,35,38,40,51,52,53 janë ofruar çmime prej 0.1 euro etj.

Këto janë disa prej shumë pozicioneve të cilat i cekëm, e që janë ofruar çmime ekstrem të ulëta nga OE i rekomanduar për kontratë, mirëpo edhe në pozicione tjera i njëjti operator ekonomik ka ofruar çmime shumë të ulëta.

Në lidhje me disa prej pozicioneve për çmimet e ulëta, autoriteti kontraktues me dt.20.12.2022 ka kërkuar sqarime (pozicionet: 3,5, 9 deri 16, 25 deri 32, 38, 49, 51 deri 59, 67 dhe pozicionin 68), por që këto sqarime janë kërkuar në mënyrë selektive dhe vetëm prej disa pozicioneve e jo për të gjitha pozicionet ku ka ofruar çmime jo normalisht të ulëta.

Me sqarime shtesë, i njëjti operator ekonomik ka ofruar si dëshmi një profaturë nga një kompani private, kinse ka marr ofertë me çmime më të ulëta, se sa çmimet që i ka ofruar OE i rekomanduar për kontratë, mirëpo ju sqarojmë se këto janë çmime ekstrem jo serioze dhe të pamundshme për tu ofruar.

Në profaturën e ofruar, shihet që e njëjta kompani që e ka lëshuar këtë profaturë për afërsisht rreth ose mbi 70 % të pozicioneve nuk i ka vetë, pra nuk i përmban. Kjo vërtetohet me faktin se nëse shikohet web faqja e kësaj kompanie kuptohet një gjë e tillë.

Profatura në fjalë është bërë formalisht apo më mirë të themi është profaturë sa për sy e faqe sepse çmimet që janë shënuar në atë profaturë janë më të vërtetë jo reale dhe të pamundshme për tu furnizuar, madje janë vetëm janë çmime të imagjinuara. Këto çmime nuk mund të ofrohen edhe nëse do të ishte vetë prodhues kompania në fjalë.

Se profatura përmban çmime jo reale dhe jo në harmoni me çmimet e tregut, e tregojnë çmimet e profaturës si në vijim:

Pozicionet 3 dhe 4 ku janë dhënë oferta me çmime prej 0.85 euro

Pozicioni 11, çmimi 0.17 euro

Pozicionet 25-32 me çmime 0.09 euro

Pozicionet 51,93,96 me çmime 0.09 euro

Po ashtu është e pakuptimtë dhe është e pamundur që Fyt- E27 të kushtojë 4.25 euro, ndërsa trupa ndriqes 56 W dhe 84 W 0.85 euro dhe kontaktori (PM) të kushtojë 0.17 euro.

Në përgjigjen e dhënë OE i rekomanduar për kontratë në lidhje me çmimet e ofruara, ndër të tjera e ka cekur si në vijim:

Në mënyrë vetem me mirëmbajtje dhe ndërtim të rrjeteve ndriçuese publike dhe kemi një përvojë madhe në këtë fushë, andaj edhe në këtë rast kjo është një përparësi e madhe e cila na ndihmon që kemi njohuri me atë se për cilët artikuj do ketë më shumë nevojë e për cilët më pak. Pra në artikujt që më shumë nevojë dhe shpenzohen më shumë, kemi llogaritur të ofrojmë edhe me çmime më të ulëta se edhe kemi vepruar.

Në këtë pjesë të përgjigjes, OE i rekomanduar për kontratë faktikisht e ka pranuar se ka ofertuar me çmime manipulative dhe këtë veprim e ka bërë pikërisht duke u bazuar në njohuritë që i ka në lidhje me atë se cilat sasi të pozicioneve mund të kërkojnë më shumë e cilat më pak.

OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se nuk ka ofruar asnjë deklaratë për garancion për furnizimet dhe montimet që do të bëhen, edhe pse tek paramasa është kërkuar që garancioni të jetë tri vite. Me këtë fakt kuptohet që OE i rekomanduar për kontratë ka bërë shmangie të përgjegjësisë në lidhje me ofertën e tij dhe në raport me kërkesat e dosjes së tenderit dhe përshkrimeve në paramasë. I njëjti operator ekonomik, madje nuk ka ofruar asnjë deklaratë as për specifikime teknike sipas aneksit I të dosjes së tenderit.

Në dosje të tenderit tek neni 9.1&9.2 e FDT-së është kërkuar si në vijim: Kërkesa nr.2- *"OE duhet të prezantoj stafin e nevojshëm që do të angazhohet në këtë projekt min.5 punëtorë të mjaftueshëm për kryerjen e projektit"*, ndërsa dëshmi e kërkuar dokumentare është kërkuar *"Lista e stafit duhet të dorëzohet në origjinal e cila duhet të përmbajë Emrin, Mbledhjen, Profesionin, dhe pozicionin të angazhuar me parakontratë në kompani"*.

OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka përmbushur këtë kërkesë sepse listën nuk e ka ofruar sipas kërkesës dhe nuk përputhen të dhënat e punëtorëve me angazhimet e tyre dhe me kontratën, si p.sh.

Ahmet Vitia tek lista e punëtorëve shkruan se është elektrikist, ndërsa në kontratë menaxher. Asrit Vitia tek lista e punëtorëve shkruan se është mjeshër, ndërsa në kontratë elektrikist. Arditi Vitia tek lista e punëtorëve shkruan se është mjeshër, ndërsa në kontratë punëtor. Milaim Vitia tek lista e punëtorëve shkruan se është shofer, ndërsa në kontratë elektrikist. Armend Vitia tek lista e punëtorëve shkruan se është punëtor fizik, ndërsa në kontratë shofer kranipunëtor.

Egzon Gashi tek lista e punëtorëve shkruan se është punëtor fizik, ndërsa në kontratë elektrikist.

Fatlum Haziri tek lista e punëtorëve shkruan se është punëtor fizik, ndërsa në kontratë elektrikist-punëtor.

Përparim Vitia tek lista e punëtorëve shkruan se është punëtor fizik, ndërsa në kontratë elektrikist -punëtor.

Nga këto dëshmi të cilat i elaboruam më lartë, kuptohet se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm, sepse nuk ka plotësuar edhe kërkesën nr.2 të nenit 9.1&9.2 të FDT-së, pasi që ka mospërputhje të të dhënave të prezantuara në listë me kontratat përkatëse dhe ka dallime të dukshme, e të cilat dëshmojnë papërgjegjshmërinë e OE të rekomanduar për kontratë.

OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm sepse ka ofruar një marrëveshje me kompaninë NSH MVR ELEKTROMONTUES për marrje me qira të IVECO furgon korp dyer 5 me afat të shfrytëzimit të shpirtës tri vite, por që i cili afat fillon të rrjedh nga data 05.03.2025. Pra kjo marrëveshje nuk vlen për këtë projekt.

OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar një marrëveshje për qiramarrje të kamionit MAN me vinq me dy dyer, ngjyrë e verdhe me vit prodhimi 1990, Nr.shasisë:WVMLO4273G058978, ku kjo marrëveshje është e nënshkruar me

dt. 14.09.2021 dhe është me afat të pacaktuar, por që nga ajo kohë kur është lidh marrëveshja, nuk dihet se te kush mund të gjendet tani Kamioni dhe nuk dihet a është huazuar dikund apo ku gjendet.

Në marrëveshjet për qiramarrje të pajisjeve askund nuk ceket se pajisjet merren në qira për këtë projekt, prandaj këto marrëveshje nuk duhet të konsiderohen valide dhe duhet të shpallet i papërgjegjshëm OE i rekomanduar për kontratë edhe për këto arsye.

Nga të gjitha sqarimet që u bënë më lartë kuptohet se OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me çmime jonormalisht të ulëta dhe është dashur të konsiderohet si i tillë konform nenit 61 të LPP-së dhe sipas nenit 41 të Rregullores Nr.001/2022 për prokurim publik.

Autoriteti kontraktues në këtë rast është dashur ta eliminojë OE e rekomanduar për kontratë sipas nenit 41.10 pika b e Rregullores Nr.001/2022 për prokurim publik, sepse OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar sqarime të nevojshme dhe bindëse për ofertën e tij për pozicione.

Ju lutem që të analizoni edhe njëherë ofertën e OE të rekomanduar për kontratë!

OE Anesi SHPK është i papërgjegjshëm sepse prej 97 pozicioneve sa janë gjithsejtë, në 54 prej tyre ka ofruar çmime jo normalisht të ulëta, si p.sh.

Pozicioni nr.5, ka ofertuar me 30 euro, kurse në treg sillet rreth 40 euro

Pozicioni nr.11, ka ofertuar me 0.1 euro, kurse në treg sillet rreth 20 euro

Pozicioni nr.25, ka ofertuar me 0.1 euro, kurse në treg sillet rreth 4 euro

Pozicioni nr.26, ka ofertuar me 0.1 euro, kurse në treg sillet rreth 4 euro

Pozicioni nr.29, ka ofertuar me 0.1 euro, kurse në treg sillet rreth 8 euro

Pozicioni nr.54, ka ofertuar me 0.1 euro, kurse në treg sillet rreth 4 euro

Pozicioni nr.57, ka ofertuar me 0.1 euro, kurse në treg sillet rreth 4 euro

Pozicioni nr.58, ka ofertuar me 0.1 euro, kurse në treg sillet rreth 2 euro

Pozicioni nr.93, ka ofertuar me 0.1 euro, kurse në treg sillet rreth 8 euro

Pozicioni nr.94, ka ofertuar me 0.1 euro, kurse në treg sillet rreth 1.5 euro

Pozicioni nr.96, ka ofertuar me 0.1 euro, kurse në treg sillet rreth 5 euro

Gjithashtu ky OE është i papërgjegjshëm edhe për faktin se nuk ka ofruar asnjë deklaratë për garancion për furnizimet dhe montimet që do të bëhen, edhe pse tek paramasa është kërkuar që garancioni të jetë tri vite.

I njëjti operator ekonomik, madje nuk ka ofruar asnjë deklaratë as për specifikime teknike sipas aneksit 1 të dosjes së tenderit.

OE VT-3 SHPK Inline Engineering SHPK është i papërgjegjshëm sepse prej 97 pozicioneve sa janë gjithsejtë, në 26 prej tyre ka ofruar çmime jo normalisht të ulëta, p.sh.

Pozicionet: nr.25, ka ofertuar me 1 euro, ndërsa në treg sillet rreth 4 euro

Pozicionet: nr.54, ka ofertuar me 2 euro, ndërsa në treg sillet rreth 4 euro

Gjithashtu ky OE është i papërgjegjshëm edhe për faktin se nuk ka ofruar asnjë deklaratë për garancion për furnizimet dhe montimet që do të bëhen, edhe pse tek paramasa është kërkuar që garancioni të jetë tri vite.

OE Risamont SHPK është i papërgjegjshëm sepse ka ofertuar me çmime jo normalisht të ulëta në shumë pozicione, ndërsa vetëm disa prej tyre po i cekim më poshtë.

Pozicioni nr.1, ka ofertuar me 5 euro, kurse në treg sillet rreth 25 euro

Pozicioni nr.2, ka ofertuar me 5 euro, kurse në treg sillet rreth 30 euro

Pozicioni nr.5, ka ofertuar me 30 euro, kurse në treg sillet rreth 40 euro

Pozicioni nr.11, ka ofertuar me 0.2 euro, kurse në treg sillet rreth 20 euro

Pozicioni nr.23, ka ofertuar me 1 euro, kurse në treg sillet rreth 10 euro

Pozicioni nr.25, ka ofertuar me 1 euro, kurse në treg sillet rreth 4 euro

Pozicioni nr.54, ka ofertuar me 1 euro, kurse në treg sillet rreth 4 euro
Pozicioni nr.64 ka ofertuar me 1 euro, kurse në treg sillet rreth 10 euro
etj

Ky operator ekonomik është i papërgjegjshëm për shkak se lista e ofruar e punëtorëve nuk i përmban të dhënat e pozicionit të angazhimit me parakontrata.

Gjithashtu ky OE është i papërgjegjshëm edhe për faktin se nuk ka ofruar asnjë deklaratë për garancion për furnizimet dhe montimet që do të bëhen, edhe pse tek paramasa është kërkuar që garancioni të jetë tri vite.

I njëjti operator ekonomik, madje nuk ka ofruar asnjë deklaratë as për specifikime teknike sipas anëksit 1 të dosjes së tenderit.

Ne me dt.06.01.2023 kemi pranuar vendimin për kërkesën për rishqyrtim, ku e njëjta është refuzuar nga AK-ja me arsyetimin se kinse kërkesa për rishqyrtim është e pa bazuar, mirëpo që asnjëri nga pretendimet tona ankimore nuk është kundërshtuar me fakte apo dëshmi konkrete.

Në vendimin për refuzim, autoriteti kontraktues nuk ka dhënë asnjë përgjigje konkrete në lidhje me pretendimet tona ankimore por ka mbështetur vendimin e tyre pa ndonjë arsyetim konkret dhe duke konsideruar se nuk janë shkelur nenet përkatëse për të cilat kemi pretenduar ne.

Në lidhje me çmimet jo normalisht të ulëta që ka ofertuar për pozicione OE i rekomanduar për kontratë AK-ja nuk ka sqaruar asgjë por vetëm ka përshkruar që konform nenit 41 pika 41.6 ka kërkuar sqarime shpesh dhe përgjigjet i ka pranuar sipas nenit 41.7 të rregullores për prokurim publik. Kurse i ka marrë për bazë këto sqarime komisioni vlerësues sipas nenit 41.10 të RRPP.

Neni 41.6 i RRPP 001/2022 e parasheh qartë: "41.6 Në rast se një tender (apo një pozicion i tenderit ku aplikohet çmimi i peshuar për njësi) duket të jetë jo normalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues duhet të kërkojë me shkrim nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin ose pozicionin e tenderit që duket të jetë jo-normalisht i ulët sipas paragrafit 41.3 ose 41.4 të kësaj rregullore, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zbatim të detajuar të pjesëve relevante të tenderit dhe e cila përfshinë një shpjegim për çmimin e ulët duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja "Shkresa standarde për tenderët jonormalisht të ulët".

Në këtë dispozitë parashihet edhe për pozicione jonormalisht të ulëta të kërkojnë sqarime e edhe kur aplikohet çmimi i peshuar për njësi, ndërsa parashihet qartë që duhet të ofrohet deklaratë me shkrim që përfshinë zbatim të detajuar të pjesëve relevante të tenderit, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë nuk ka bërë përshkrim dhe zbatim të detajuar të pjesëve relevante të tenderit.

Autoriteti kontraktues në mënyrë të njëanshme e ka pranuar përgjigjen e OE të rekomanduar për kontratë për çmime jonormalisht të ulëta edhe pse i njëjti nuk ka ofruar sqarim dhe zbatime të detajuara, prandaj kërkojmë nga OSHP-ja që të analizojë saktë pozicionet me çmime jonormalisht të ulëta të OE të rekomanduar për kontratë dhe të vihet në përfundim profesional dhe të drejtë lidhur me këto çmime absurde të OE të rekomanduar për kontratë.

Pra sa i përket çmimeve, autoriteti kontraktues nuk ka dhënë asnjë përgjigje për asnjë pozicion të cilin ne e kemi elaboruar dhe faktuar që janë me çmime jonormalisht të ulëta, prandaj ky fakt tregon se AK-ja nuk ka mundur të jep përgjigje adekuate dhe reale në lidhje me pozicionet për të cilat ka ofruar çmime jo normalisht të ulëta OE i rekomanduar për kontratë.

Prej 54 pozicioneve të cilat i kemi sqaruar se janë ofruar me çmime jonormalisht të ulëta nga OE i rekomanduar për kontratë, me asnjërin pozicion nuk është marrë autoriteti

kontraktues. Gjithashtu nuk është marrë as me arsyetimin tonë që e kemi bërë në lidhje me një profaturë që OE i rekomanduar për kontratë e ka prezantuar për të arsyetuar çmime jo normalisht të ulëta.

Gjithashtu edhe sa i përket pretendimit për listë të stafit dhe deklaratë për specifikime teknike dhe për garancion, autoriteti kontraktues nuk ka dhënë ndonjë përgjigje konkrete, duke theksuar se paramasën e ka nënshkruar OE i rekomanduar për kontratë e aty kanë qenë specifikimet teknike.

Kurse sa i përket stafit ka deklaruar se komisioni vlerësues ka konstatuar se OE i rekomanduar për kontratë e plotëson kërkesën dhe se ka ofruar staf më shumë se sa është kërkuar.

Sa i përket garancionit të kërkuar tek paramasa, autoriteti kontraktues insiston se OE i rekomanduar për kontratë ka nënshkruar dhe vulosur specifikimet teknike, mirëpo kjo nuk është dëshmi konkrete se ky OE ka dhënë garancion nga tri vite aq sa është kërkuar, sepse garancioni duhet të jepet me deklaratë të nënshkruar dhe të vulosur. Pra OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar deklaratë për garancion e që faktikisht i bie se i njëjti OE nuk garanton për produktet e ofruara.

Sa i përket listës së punëtorëve, ne në detaje e kemi sqaruar pretendimin tonë duke shënuar me emra stafin të cilëve nuk ju përputhen pozitat në kontratat e tyre me përshkrimin tek lista e stafit, por autoriteti kontraktues nuk është lëshuar në këto pretendime të detajuara por vetëm me një fjali e ka konsideruar si të pabazuar pretendimin tonë.

Gjithashtu AK-ja nuk ka kthyer fare përgjigje në lidhje me pretendimet tona ankimore sa i përket paisjeve dhe marrëveshjes për marrjen me qira të mjeteve. Përderisa AK-ja nuk ka kthyer përgjigje në pretendimin e lartcekur, atëherë kuptohet qartë fakti se pretendimi ynë ankimor është i bazuar, pasi që në të kundërtën AK-ja do ta kishte kundërshtuar pretendimin tonë ankimor me fakte dhe dëshmi konkrete.

Nga faktet e lartcekura, shihet qartë se vendimi për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim është i pa bazuar dhe i paqëndrueshëm, njëkohësisht AK-ja ka favorizuar hapas OE të rekomanduar për kontratë.

Nga të gjitha dëshmitë që u cekën në tekst më lartë, kuptohet që ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë sipas nenit 59 të LPP-së, sepse është shpallur tenderues i suksesshëm, madje është rekomanduar për kontratë një OE i cili nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e PD1-së dhe të njoftimit për kontratë, kurse përveç këtij fakti i njëjti OE ka ofertuar edhe me çmime jo normalisht të ulëta.

Nuk është respektuar edhe neni 61 i LPP-së dhe neni 41 i rregullorës Nr.001/2022 për prokurim publik, sepse oferta e OE të rekomanduar për kontratë është dashur të konsiderohet me çmime jo normalisht të ulëta sipas dispozitave të lartcekura.

Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, sepse paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parashihet qartë që "Autoriteti kontraktues do të trajtojë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente, ndërsa AK-ja nuk e ka zbatuar këtë dispozitë sepse neve na ka diskriminuar si OE i përgjegjshëm, kurse ka favorizuar OE e rekomanduar për kontratë.

Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më

të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të marrë:

V E N D I M

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE "NNP Ndriqimi"

ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda kthehet në

RIVLERËSIM.

DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

Pretendimet ankimore të parashtruara në ankesën e deponuar në OSHP, janë/ nuk janë të njëjta me pretendimet ankimore të parashtruara në Kërkesën për rishqyrtim të dorëzuar të AK.

KRITERET PËR VLERËSIM

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "NDREQIMI" lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja e Ndriqimit Publik", me numër të prokurimit: OB614-22-13548 -2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Kuvendi Komunal - Obiliq.

Të vendosen vetëm kërkesa/kriteret që kanë të bëjnë me arsyet e eliminimit dhe / apo ato kërkesa që lidhen me pretendimet ankimore.

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	Kapaciteti teknik dhe profesional:	Dëshmia e kërkuar dokumentare
		Kërkesa nr.2 OE duhet të prezentoj stafin e nevojshëm që do të angazohet në këtë projekt (min.5 punëtorë të mjaftueshëm për kryerjen e projektit).	Dëshmia nr.2 Lista e stafit duhet të dorëzohet në origjinal e cila duhet të përmbajë Emrin, Mbiemrin, Profesionin, dhe pozicionin të angazhuar me parakontratë në kompani
		Kërkesa nr.4 OE me një listë duhet të paraqet pajisjet për mjetet stabilimentet që ka në dispozicion për realizimin e projektit. a)min Dy (2) Autoshoportë për ngritje dhe intervenim në lartësi b)min një Kamionetë me mekanizëm të veçant (vinç) për ngritje të shtyllave në lartësi si dhe mjete tjera të nevojshme për këtë projekt	Dëshmia nr .4 Lista e paisjeve duhet të dorëzohet në origjinal - Listes duhet të bashkëngjiten fotografit me të cilat identifikohen pajisjet e kërkuara dhe njëra nga këto dëshmi kopje të librezës së qarkullimit, Ose DUD doganorë, ose faturë për blerjen ose Kontrata mbi qiramarrjenin..

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:
(Të përshkruhet vetëm vlerësimi i ofertës së OE ankues /ofertave, për të cilat OE ankues ka pretendime ankimore).

B46-Letër standarde për tenderuesin e pasuksesshëm 3

28.12.2022, Obiliq

Autoriteti Kontraktues: Komuna e Obiliqit

N.N.P. " NDRIQIMI ", Lut Vuku, 10000, Prishtinë

Nr. i prokurimit: OB614-22-13548-2-2-1

Titulli: Mirëmbajtja e Ndriqimit Publik

I/c nderuar(a)

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kriterëve të dhëna në Njoftimin për Kontratë dhe ne Dosjen e Tenderit.

Me keqardhje ju njoftojmë se tenderi i paraqitur nga ana juaj nuk qe i suksesshëm, ngase tenderi juaj nuk qe tenderi më i miri në mesin e tenderëve që plotësonin kërkesat e dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Ju informojmë se kontrata i është dhënë " Item EL " SH.P.K., Rr.Burim Vitia, 10000, Prishtinë një shumë prej 179.50€

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të paraqitni ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Dhënia e kontratës është e përkohshme dhe nuk përbën një marrëveshje kontraktuale deri në skadimin e intervalit, gjatë të cilit ofertuesit e pasuksesshëm mund të kërkojnë shqyrtimin e vendimit.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit .

OPERATORI EKONOMIK " Item EL " është ofertë e rekomanduar për kontratë

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE " NDREQIMI " lidhur me aktivitetin e prokurimit " Mirëmbajtja e Ndriqimit Publik ", me numër të prokurimit: OB614-22-13548-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Kuvendi Komunal - Obiliq.

**INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E
EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK**

Nuk ka marre eksperti shqyrtues informacione shitese

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet një vlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26).

//////

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

(Të sqarohet nëse për rastin e njejtë është dhënë vlerësim tjetër).

Nuk ka vendime të më hershme për këto aktivitete të prokurimit

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).

Nuk kemi devijim nga praktikat e më hershme

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES NNP " NDREQIMI "

Përgjigje në Pretendim nr.1

Pretendimi ankimor i OE ankues sipas mendimit të ekspertit shqyrtues është i bazuar pasi që Lista e çmimeve për pozicione/artikuj të ofruara nga Operatori Ekonomik i rekomanduar kontrata ka çmime abnormalisht të ulta që nuk përkojnë me çmimet e tregut. Ne vijim do të paraqesë pozicionet ku e OE i rekomanduar për kontrate ka ofruar çmimet për njësi si ne vijim:

2	Furnizimi, transporti dhe montimi i trupit LED me këto karakteristika: Tensioni hyrës: 90-264 V AC, 50-60 Hz, DC LED Q' ty& Fuqia: 50W Frequency Range 50 – 60 HZ Eficienca: min 90 lm/W Power LED Color Temperature: >4000 Material: Aluminium Qendrueshmëria min 50000 orë pune Garancioni 3 vite.	copë	1	30	30.00 €	
3	Furnizimi, transporti dhe montimi i trupit LED me këto karakteristika: Tensioni hyrës: 90-264 V AC, 50-60 Hz, DC LED Q' ty& Fuqia: 56W Frequency Range 50 – 60 HZ Eficienca: 120 lm/W Power LED Color Temperature: >4000 Material: Aluminium Qendrueshmëria min 50000 orë pune Garancioni 3 vite.	copë	1	1	1.00 €	18.50
4	Furnizimi, transporti dhe montimi i trupit LED me këto karakteristika: Tensioni hyrës: 90-264 V AC, 50-60 Hz, DC LED Q' ty& Fuqia: 84W Frequency Range 50 – 60 HZ Eficienca: min 90 lm/W Power LED Color Temperature: >4000 Material: Aluminium Qendrueshmëria min 50000 orë pune Garancioni 3 vite.	copë	1	1	1.00 €	0.55
5	Furnizimi, transporti dhe montimi i trupit LED me këto karakteristika: Tensioni hyrës: 90-264 V AC, 50-60 Hz, DC LED Q' ty& Fuqia: 100W Frequency Range 50 – 60 HZ Eficienca: min 90 lm/W Power LED Color Temperature: >4000 Material: Aluminium Qendrueshmëria min 50000 orë pune Garancioni 3 vite.	copë	1	30	30.00 €	0.55
						16.50

Ne foton me larte te pozicionet me numër 2,3,4 dhe 5 përshkrimi është i njëjtë mirëpo dallon vetëm LED Q' ty& fuqia. Te pozicioni me numër 2 fuqia është 50W dhe çmimi është i ofruar është 30.00€ ndërsa te pozicioni me numër 3 është kërkuar fuqia 56W dhe pozicioni me numër 4 është kërkuar fuqia 84W Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontrate ka vendosur çmimin prej 1.00 për te dy pozicionet, ndërsa për pozicionin me numër 5 është kërkuar fuqia 100W ka çmim prej 30.00€. Duke marrë parasysh dallimin e fuqisë ne Wate (W) konsiderojë qe OE ka ofruar çmime manipulative qe nuk janë çmime te tregut duke marrë parasysh qe Operatori Ekonomik do te beje furnizimin, transportin dhe montimin i trupit LED dhe çmimi prej 1.00 është çmim qe nuk përkon me çmimet reale te tregut pasi qe ne çdo pozicion fuqia e wateve (W) shkon duke u rritur.

Te pozicionet me numër 9 dhe 10 çmimi i ofruar nga Operatori i rekomanduar për kontrate është 0.20€, për këto dy pozicione dhe pozicione tjera Operatori Ekonomik ankues dhe ofertues tjerë ka ofruar me një çmim të ulët.

Pozicionet me numër 15,16,27,28,29,30,31,32,34,35,38,40,51,52,53, te specifikuar ne ankesën e Operatorit Ekonomik ankues çmimet janë si ne vijim:

15	Furnizimi, transporti dhe montimi i AS me shtjellim prej 100-160A.	copë	1	0.1	0.10 €	
16	Furnizimi, transporti dhe montimi i relesë IC Astrologjike ,Siemes,Schneider,Abb ose të ngjashme.	copë	1	0.1	0.10 €	0.05
						0.05

MIRËMBAJTJA E NDRIQIMIT PUBLIK - B					
Nr.	PËRSHKRIMI I PUNËVE	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
25	Furnizimi, transporti dhe montimi i pllakave për trupat ndriqes LED për -42W.	copë	1	0.1	0.10 €
26	Furnizimi, transporti dhe montimi i pllakave për trupat ndriqes LED për -50W.	copë	1	0.1	0.10 €
27	Furnizimi, transporti dhe montimi i pllakave për trupat ndriqes LED për -56W.	copë	1	0.1	0.10 €
28	Furnizimi, transporti dhe montimi i pllakave për trupat ndriqes LED për -84W.	copë	1	0.1	0.10 €
29	Furnizimi, transporti dhe montimi i pllakave për trupat ndriqes LED për -100W.	copë	1	0.1	0.10 €
30	Furnizimi, transporti dhe montimi i pllakave për trupat ndriqes LED për -150W.	copë	1	0.1	0.10 €
31	Furnizimi, transporti dhe montimi i trafave për trupat ndriqes LED për -30W.	copë	1	0.1	0.10 €
32	Furnizimi, transporti dhe montimi i trafave për trupat ndriqes LED për -42W.	copë	1	0.1	0.10 €
33	Furnizimi, transporti dhe montimi i trafave për trupat ndriqes LED për -50W.	copë	1	16	15.00 €
34	Furnizimi, transporti dhe montimi i trafave për trupat ndriqes LED për -56W.	copë	1	0.1	0.10 €
35	Furnizimi, transporti dhe montimi i trafave për trupat ndriqes LED për -84W.	copë	1	0.1	0.10 €
36	Furnizimi, transporti dhe montimi i trafave për trupat ndriqes LED për -100W.	copë	1	10	10.00 €
37	Furnizimi, transporti dhe montimi i trupit ndriqes GLOB Ø 300 .	copë	1	5.00 €	5.00 €
38	Furnizimi, transporti dhe montimi i trupit ndriqes me poqë të CFL 60w, me lirë ,qelq dhe material tjetër i nevojshëm për përfundim.komplet	copë	1	0.1	0.10 €
39	Furnizimi, transporti dhe montimi i siguresave , automatike 40A - 63 A	copë	1	10	10.00 €
40	Furnizimi, transporti dhe vendosja e siguresës automatike Schneider ose e ngjashme 1-0-2 ,25A, e vendosur në ormanin e grupit matës.	copë	1	0.1	0.10 €
51	Furnizimi, transporti dhe montimi i llrave dy anësore (mbajtës të trupave ndriqes1.50m me hark).	copë	1	0.1	0.10 €
52	Furnizimi, transporti dhe montimi i relese 38 fazave	copë	1	0.1	0.10 €
53	Programimi i relese IC Astro	copë	1	0.1	0.10 €
54	Furnizimi, transporti dhe montimi i aranditëve për shtylla të metalit me 4 pika.	copë	1	0.1	0.10 €
55	Furnizimi dhe montimi, dritave ekonomike horizontale 80W	copë	1	0.1	0.10 €
56	Furnizimi dhe montimi, dritave ekonomike horizontale 65W	copë	1	0.1	0.10 €
57	Furnizimi dhe montimi, dritave ekonomike horizontale 35W	copë	1	0.1	0.10 €
58	Furnizimi dhe montimi, dritave ekonomike horizontale 20W	copë	1	0.1	0.10 €
93	Furnizimi, transporti dhe montimi i vazhduesve kabllovk (muf) me dim. 50, 25, dhe 16mm ² (qimi.Mesatorë)	copë	1	0.1	0.10 €
94	Hapja e kanalit nëntokësor me dim. 0.4x1m, për vendosjen e rrjetit të ndriqimit publik	m ¹	1	0.1	0.10 €

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE " NDREQIMI " lidhur me aktivitetin e prokurimit " Mirëmbajtja e Ndririmit Publik ", me numër të prokurimit: OB614-22-13548 -2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Kuvendi Komunal - Obiliq.

96	Role Kohore	copë	1	0.1	0.10 €	0.02
----	-------------	------	---	-----	--------	------

Duke ju referuar listës së pozicioneve me lartë vërejt se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka ofruar çmime jo reale me tregun. Në lidhje me çmimet e ofruara për këtë aktivitet të prokurimit Autoriteti Kontraktues duhet hulumtoj çmimet e tregut. Konformë nenit 17 të LPP-së, Gjatë përcaktimit të vlerës së parashikuar të një kontrate të propozuar për shërbime, autoriteti kontraktues do t'i përfshijë të gjitha elementet e çmimit përfundimtar që mund të parashikohen në mënyrë të arsyeshme, që do të paguhet nga autoriteti kontraktues për shërbimet dhe lëndët e tilla, duke përfshirë çfarëdo dhe të gjitha taksat, detyrimet dhe tarifatat të tjera nga kjo Autoriteti Kontraktues duhet të këtë paramasen me çmime për secilin pozicion sesi ka arrit deri te vlera e parashikuar e aktivitetit të prokurimit.

Duke ju referuar listës së pozicioneve të sipër përmendura me lartë, për mendimin e ekspertit shqyrtues është se pretendimi ankimore i Ankuesit është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.2

Pretendimi ankimor i OE ankues sipas dosjes së tenderit **Kapaciteti teknik dhe profesional:**

Kërkesa nr.2 OE duhet të prezantoj stafin e nevojshëm që do të angazhohet në këtë projekt (min.5 punëtorë të mjaftueshëm për kryerjen e projektit). Ndërsa të **Dëshmia e kërkuar dokumentare**

Dëshmia nr.2 Lista e stafit duhet të dorëzohet në origjinal e cila duhet të përmbajë Emrin, Mbiemrin, Profesionin, dhe pozicionin të angazhuar me parakontratë në kompani.

Duke ju referuar dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë të kërkesat dhe dëshmit për Kapaciteti teknik dhe profesionale dhe dëshmit të dorëzuara në ofertën e Operatorit Ekonomik të rekomanduar për kontratë që ka të bëjë me Listën e punëtorëve ka mos përputhje pozita e punëtorëve me kontratë të punës për me tepër shih listën e punëtorëve dhe kontratat e punës si në vijim:

LISTA E PUNËTOREVE ITEM EL sh.p.k				
NR	EMRI	MBIEMRI	NR/Personal	POZITA
1	ABAZ	KELMENDI	1004546730	INXHINIER
2	AHMET	VITIA	1230595271	ELEKTRICIST
3	ASTRIT	VITIA	1250931288	MJESHTËR
4	ARDIT	VITIA	1248642213	MJESHTËR
5	MILAIM	VITIA	1015039198	SHOFER
6	ARMEND	VITIA	1244408331	PUNTOR FIZIK
7	EGZON	GASHI	1249790059	PUNTOR FIZIK
8	FATLUM	HAZIRI	1247810443	PUNTOR FIZIK
9	PERPARIM	VITIA	1248500574	PUNTOR FIZIK

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE " NDREQIMI " lidhur me aktivitetin e prokurimit " Mirëmbajtja e Ndriqimit Publik ", me numër të prokurimit: OB614-22-13548 -2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Kuvendi Komunal - Obiliq.

Në bazë të nenit 10 paragrafi 2, pikat 2.1 dhe 2.2, dhe nenit 11 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, më dt. 01.12.2010, Punëdhënësi dhe i Punësuari, si subjekte të marrëdhënies juridike të punës, lidhin:

**KONTRATË PUNE
PËR
KOHË TË CAKTUAR**

Neni 1

Me këtë Kontratë: "Item EL "SHPK, Hajvali -Prishtine ,810091942
(emri/emërtimi, selia, adresa dhe numri i regjistrimit të biznesit punëdhënësit)
të cilin e përfaqëson: Item EL "SHPK (në tekstin e mëtejshëm: Punëdhënësi), lidhë kontratë
pune me: Ahmet Vitia, 123059527 , Prishtine
(emri dhe mbiemri i të punësuarit, numri personal, kualifikimi dhe adresa e të punësuarit
(në tekstin e mëtejshëm: i punësuar).

Neni 2

I punësuar do të kryej këto detyra të punës: Menaxher

(emërtimi, natyra, lloji i punës dhe përshkrimi i detyrave të punës).

Neni 3

I punësuar do të kryejë punët në: "Item EL "SHPK, _____

(vendi i punës ku do të kryhet puna, si dhe njoftimi që puna do të kryhet në lokacione të ndryshme).

Në bazë të nenit 10 paragrafi 2, pikat 2.1 dhe 2.2, dhe nenit 11 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, më dt. 01.12.2010, Punëdhënësi dhe i Punësuari, si subjekte të marrëdhënies juridike të punës, lidhin:

**KONTRATË PUNE
PËR
KOHË TË CAKTUAR / TË PACAKTUAR**

Neni 1

Me këtë Kontratë: "Item EL "SHPK, Hajvali -Prishtine ,810091942
(emri/emërtimi, selia, adresa dhe numri i regjistrimit të biznesit punëdhënësit)
të cilin e përfaqëson: Ahmet Vitia (në tekstin e mëtejshëm: Punëdhënësi), lidhë
kontratë pune me: Astrit Vitia, 1250931286, Prishtine
(emri dhe mbiemri i të punësuarit, numri personal, kualifikimi dhe adresa e të punësuarit
(në tekstin e mëtejshëm: i punësuar).

Neni 2

I punësuar do të kryej këto detyra të punës: Elektricitist

(emërtimi, natyra, lloji i punës dhe përshkrimi i detyrave të punës).

Neni 3

I punësuar do të kryejë punët në: "Item EL "SHPK, _____

(vendi i punës ku do të kryhet puna, si dhe njoftimi që puna do të kryhet në lokacione të ndryshme).

Neni 4

Në bazë të nenit 10 paragrafi 2, pikat 2.1 dhe 2.2, dhe nenit 11 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, më dt. 01.12.2010, Punëdhënësi dhe i Punësuari, si subjekte të marrëdhënies juridike të punës, lidhin:

**KONTRATË PUNE
PËR
KOHË TË CAKTUAR / TË PACAKTUAR**

Neni 1

Me këtë Kontratë: "Item El "SHPK, Hajvali -Prishtine ,810091942
(emri/emërtimi, selia, adresa dhe numri i regjistrimit të biznesit punëdhënësi)
të cilin e përfaqëson: Ahmet Vitia (në tekstin e mëtejshëm: Punëdhënësi), lidhë
kontratë pune me: Arditi Vitia, 1248542213, Prishtine "
(emri dhe mbiemri i të punësuarit, numri personal, kualifikimi dhe adresa e të punësuarit
(në tekstin e mëtejshëm: i punësuar).

Neni 2

I punësuari do të kryej këto detyra të punës: _____ Punetore _____

(emërtimi, natyra, lloji i punës dhe përshkrimi i detyrave të punës).

Neni 3

I punësuari do të kryejë punët në: "Item El "SHPK, _____

(vendi i punës ku do të kryhet puna, si dhe njoftimi që puna do të kryhet në lokacione të ndryshme).

Neni 4

Në bazë të nenit 10 paragrafi 2, pikat 2.1 dhe 2.2, dhe nenit 11 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, më dt. 01.12.2010, Punëdhënësi dhe i Punësuari, si subjekte të marrëdhënies juridike të punës, lidhin:

**KONTRATË PUNE
PËR
KOHË TË CAKTUAR / TË PACAKTUAR**

Neni 1

Me këtë Kontratë: "Item El "SHPK, Hajvali -Prishtine ,810091942
(emri/emërtimi, selia, adresa dhe numri i regjistrimit të biznesit punëdhënësi)
të cilin e përfaqëson: Ahmet Vitia (në tekstin e mëtejshëm: Punëdhënësi), lidhë
kontratë pune me: Milaim Vitia, 1015039198, Prishtine
(emri dhe mbiemri i të punësuarit, numri personal, kualifikimi dhe adresa e të punësuarit
(në tekstin e mëtejshëm: i punësuar).

Neni 2

I punësuari do të kryej këto detyra të punës: _____ Elektriciist _____

(emërtimi, natyra, lloji i punës dhe përshkrimi i detyrave të punës).

Neni 3

I punësuari do të kryejë punët në: "Item El "SHPK, _____

(vendi i punës ku do të kryhet puna, si dhe njoftimi që puna do të kryhet në lokacione të ndryshme).

Në bazë të nenit 10 paragrafi 2, pikat 2.1 dhe 2.2, dhe nenit 11 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, më dt. 01.12.2010, Punëdhënësi dhe i Punësuarit, si subjekte të marrëdhënies juridike të punës, lidhin:

**KONTRATË PUNE
PËR
KOHË TË CAKTUAR / TË PACAKTUAR**

Neni 1

Me këtë Kontratë: "Item El "SHPK, Hajvali -Prishtine ,810091942
(emri/emërtimi, selia, adresa dhe numri i regjistrimit të biznesit punëdhënësit)
të cilin e përfaqëson: Ahmet Vitiu (në tekstin e mëtejshëm: Punëdhënësi), lidhë
kontratë pune me: Armend Vitiu, 1244105331, Hajvali ,Prishtine
(emri dhe mbiemri i të punësuarit, numri personal, kualifikimi dhe adresa e të punësuarit
(në tekstin e mëtejshëm: i punësuar).

Neni 2

I punësuarit do të kryej këto detyra të punës: Shofer krani-Punetor

(emërtimi, natyra, lloji i punës dhe përshkrimi i detyrave të punës).

Neni 3

I punësuarit do të kryejë punët në: "Item El "SHPK,

(vendi i punës ku do të kryhet puna, si dhe njoftimi që puna do të kryhet në lokacione të ndryshme).

Neni 4

Në bazë të nenit 10 paragrafi 2, pikat 2.1 dhe 2.2, dhe nenit 11 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, më dt. 01.12.2010, Punëdhënësi dhe i Punësuarit, si subjekte të marrëdhënies juridike të punës, lidhin:

**KONTRATË PUNE
PËR
KOHË TË CAKTUAR / TË PACAKTUAR**

Neni 1

Me këtë Kontratë: "Item El "SHPK, Hajvali -Prishtine ,810091942
(emri/emërtimi, selia, adresa dhe numri i regjistrimit të biznesit punëdhënësit)
të cilin e përfaqëson: Ahmet Vitiu (në tekstin e mëtejshëm: Punëdhënësi), lidhë
kontratë pune me: Egzon Gashi, 1249790059, Prishtine
(emri dhe mbiemri i të punësuarit, numri personal, kualifikimi dhe adresa e të punësuarit
(në tekstin e mëtejshëm: i punësuar).

Neni 2

I punësuarit do të kryej këto detyra të punës: Elektriciist

(emërtimi, natyra, lloji i punës dhe përshkrimi i detyrave të punës).

Neni 3

I punësuarit do të kryejë punët në: "Item El "SHPK,

(vendi i punës ku do të kryhet puna, si dhe njoftimi që puna do të kryhet në lokacione të ndryshme).

Neni 4

Në bazë të nenit 10 paragrafi 2, pikat 2.1 dhe 2.2, dhe nenit 11 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, më dt. 01.12.2010, Punëdhënësi dhe i Punësuarit, si subjekte të marrëdhënies juridike të punës, lidhin:

**KONTRATË PUNE
PËR
KOHË TË CAKTUAR / TË PACAKTUAR**

Neni 1

Me këtë Kontratë: "Item El "SHPK, Hajvali -Prishtine ,810091942
(emri/emërtimi, selia, adresa dhe numri i regjistrimit të biznesit punëdhënësit)
të cilin e përfaqëson: Ahmet Vitiu (në tekstin e mëtejshëm: Punëdhënësi), lidhë
kontratë pune me: Fatlum Haziri, 1247810443, Busi, Prishtine
(emri dhe mbiemri i të punësuarit, numri personal, kualifikimi dhe adresa e të punësuarit
(në tekstin e mëtejshëm: i punësuar).

Neni 2

I punësuarit do të kryej këto detyra të punës: Elektriciist-Punetor

(emërtimi, natyra, lloji i punës dhe përshkrimi i detyrave të punës).

Neni 3

I punësuarit do të kryejë punët në: "Item El "SHPK,

(vendi i punës ku do të kryhet puna, si dhe njoftimi që puna do të kryhet në lokacione të ndryshme).

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE " NDREQIMI " lidhur me aktivitetin e prokurimit " Mirëmbajtja e Ndriqimit Publik ", me numër të prokurimit: OB614-22-13548 -2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Kuvendi Komunal - Obiliq.

Në bazë të nenit 10 paragrafi 2, pikat 2.1 dhe 2.2, dhe nenit 11 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, më dt. 01.12.2010, Punëdhënësi dhe i Punësuar, si subjekte të marrëdhënies juridike të punës, lidhin:

**KONTRATË PUNE
PËR
KOHË TË CAKTUAR / TË PACAKTUAR**

Neni 1

Me këtë Kontratë: "Item El "SHPK, Hajvali -Prishtine ,810091942
(emri/emërtimi, selia, adresa dhe numri i regjistrimit të biznesit punëdhënësi)
të cilin e përfaqëson: Ahmet Vlda (në tekstin e mëtejshëm: Punëdhënësi), lidhë
kontratë pune me: Perparim Vllia, 1248600574, Hajvali, Prishtine
(emri dhe mbiemri i të punësuarit, numri personal, kualifikimi dhe adresa e të punësuarit
(në tekstin e mëtejshëm: i punësuar).

Neni 2

I punësuar do të kryej këto detyra të punës: _____ Elektriciist-Punetor _____
(emërtimi, natyra, lloji i punës dhe përshkrimi i detyrave të punës).

Neni 3

I punësuar do të kryejë punët në: _____ "Item El "SHPK, _____
(vendi i punës ku do të kryhet puna, si dhe njoftimi që puna do të kryhet në lokacione të
ndryshme).

Neni 4

Për mendimin e ekspertit shqyrtues pretendimi ankimore i Ankuesit është i bazuar pasi që ka mos përputhje të pozitave në listën e punëtorëve dhe kontratave të punës.

Përgjigje në Pretendimi nr.3.

Pretendimi ankimor i OE ankues sipas dosjes së tenderit **Kapaciteti teknik dhe profesional:**

Kerkesa nr.4 OE me një listë duhet të paraqet pajisjet për mjetet stabilimentet që ka në dispozicion për realizimin e projektit. a)min Dy(2) Autoshtportë për ngritje dhe intervenim në lartësi b)min një Kamionetë me mekanizëm të veçant (vinç) për ngritje të shtyllave në lartësi si dhe mjete tjera të nevojshme për këtë projektNdërsa të Dëshmia e kërkuar dokumentare

Dëshmia nr.4 Lista e paisjeve duhet të dorëzohet në origjinal -Listes duhet të bashkëngjiten ,fotografit me të cilat identifikohen pajisjet e kërkuara dhe njëra nga këto dëshmi kopje të librezës së qarkullimit, Ose DUD doganorë, ose faturë për blerjen ose Kontrata mbi qiramarrjenin..

Duke ju referuar dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë të kërkesat dhe dëshmitë për Kapaciteti teknik dhe profesionale në bazë të dëshmimeve të dorëzuara në ofertën nga Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë të kontrata mbi qiranë kjo kontratë është përpiluar dhe nënshkruar me datë 05.03.2022 nga të dy palët kontraktuese.

KONTRAT MBI QIRANË

E lidhur ndërmjet qiradhënësit dhe qiramarrësit të kamion (dy dyer) më 05.03.2022

1. N.SH MVR ELEKTROMONTUES , NF. 810898231, me vendbanim në Prishtinë në cilësinë e qiradhënësit në njërën anë, në tekstin e mëtejshëm qiradhënësi dhe ;
2. ITEMEL SH.P.K NF: 810091942, nga HAJVALI- PRISHTINAE në cilësinë e qiramarrësit në anën tjetër në tekstin e mëtejshëm qiramarrësi.

Palët kontraktuese me këtë kontratë përcaktojnë kushtet dhe obligimet sipas kësaj kontrate:

Dispozita e Përgjithshme

Neni 1

Qiradhënësi la bart qiramarrësit në shfrytëzim Iveco Furgon Korp dyer 5 , Ngjyra e Bardhe viti 2005
Nr:ZCFC65A000D262113

Neni 2

Afati shfrytëzimit të shportës është 3 vite, i cili afat rrjedh prej 05.03.2025 më afat të pacaktuar sipas nevojës, të cilin qiramarrësi do ta shfrytëzoj për kryerjen e punëve për nevoja të kompanisë.

Te neni 2 afati i shfrytëzimit është 3 vite, afat i cili rrjedh prej 05.03.2025, Sipas mendimit të ekspertit shqyrtues këtu kemi të bëjmë me lëshim teknike pasi që kjo kontratë/marrëveshje mbi qiranë është për tri (3) vite dhe vlen deri në vitin 2025 pasi që operatori ekonomik i rekomanduar ka dëshmuar kontratën mbi qiranë, foton dhe librezën e qarkullimit.

Për mendimin e ekspertit shqyrtues pretendimi ankimore i Ankuesit është i pa bazuar.

Prandaj vlerësoj se Autoriteti Kontraktues nuk ka respektuar në tërësi dispozitat e nenit 59, 61 të LPP-së dhe Neni 41 të rregullores Nr 001/2022 për Prokurim publik pasi që ofertuesit pjesë marrës në këtë aktivitet të prokurimit në pozicione të caktuara kanë çmime abnormalisht të ulët në krahasim me çmimet e tregut.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE " NDREQIMI " ankues të aprovohet e bazuar, dhe rekomandon që të anulohet B58 - Njoftimi mbi Vendimin AK dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim.

Raporti i eksperizës të dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – KUVENDI KOMUNAL - OBILIQ.
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues – NDREQIMI .

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE " NDREQIMI " lidhur me aktivitetin e prokurimit " Mirëmbajtja e Ndriqimit Publik ", me numër të prokurimit: OB614-22-13548 -2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Kuvendi Komunal - Obiliq.